



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
KOORDINATORI KOMBËTAR
KUNDËR KORRUPSIONIT

SHKOLLA E MAGJISTRATURËS

Nr. 379 prot., datë 28 /01/2023

Nr. 63 prot., datë 20 /01/2023

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

MIDIS

KOORDINATORIT KOMBËTAR KUNDËR KORRUPSIONIT

DHE

SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

“PËR TRAJNIMIN E VAZHDUESHËM TË KOORDINATORËVE NË SHKOLLËN
E MAGJISTRATURËS”

Tiranë, 2023

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi, (këtu e në vazhdim referuar si "Marrëveshja") lidhet midis:

1. Ministrit të Drejtësisë, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit,
përfaqësuar nga Z. Ulsi Manja, Ministër

dhe

2. Shkollës së Magjistraturës, përfaqësuar nga Z. Arben Rakipi, Drejtor.

Hyrje

1. *Duke vlerësuar* rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitutional për forcimin e shtetit të së drejtës, me qëllim luftën kundër korrupsionit dhe ndëshkimin e paligjshmërive, me synim garantimin e zbatimit të ligjit, mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve dhe rritjes së aftësive të koordinatorëve.
2. *Duke synuar* angazhimin e përfaqësuesve të bashkëpunimit me trajnimin e koordinatorëve, nëpërmjet përmbushjes së detyrimit për zbatimin e normave përkatëse sipas parashikimeve ligjore.
3. *Duke konfirmuar* angazhimin institucional të palëve nënshkruese për të marrë të gjitha masat dhe nismat e nevojshme për rritjen e informimit dhe trajnimit të koordinatorëve, me qëllim parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.
4. *Duke u mbështetur* në kuadrin ligjor në fuqi, si dhe në parimin e përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit.

Palët bien dakord të nënshkruajnë këtë Marrëveshje, duke respektuar dispozitat e saj, të shprehura si më poshtë:

Neni 1 **Qëllimi**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi ka për qëllim:

- bashkëpunimin e ndërsjellë në kuadër të luftës kundër korrupsionit, me qëllim nxitjen e organizimit dhe zhvillimit të veprimtarive të formimit profesional të koordinatorëve, ku përfshihet programi i formimit vazhdues të koordinatorëve në detyrë, për të përmirësuar dhe garantuar aftësitë profesionale të tyre;
- forcimin e kapaciteteve profesionale të koordinatorëve për shqyrtimin e rasteve të korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës, si dhe kryerjen e hetimeve administrative brenda fushës së përgjegjësisë të institucionit;
- sigurimin e angazhimit profesional dhe etik të koordinatorëve.

Neni 2 **Baza ligjore**

Kjo marrëveshje bazohet në vendimin nr 618, datë 20.10.2021 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, organizimin e funksionimin e Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit", i ndryshuar dhe në rregulloren e brendshme të Shkollës së Magjistratures

Neni 3 **Objekti**

Objekt i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi midis palëve lidhur me:

- hartimin dhe implementimin e programeve të posaçme për kryerjen e veprimtarive të formimit profesional të koordinatorëve.
- bashkëpunimin e palëve për identifikimin dhe zbatimin e formave të qëndrueshme dhe efektive të bashkëpunimit, në përputhje me kompetencat përkatëse institucionale, me qëllim promovimin e nismave për çështje që lidhen me luftën kundër korrupsionit dhe zbatimit të kësaj marrëveshje.

Neni 4 **Angazhimet e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit**

Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit angazhohet:

- i) të propozojë listën e aktiviteteve që do të përfshihen në veprimtarinë e formimit profesional të koordinatorëve. Për gjetjen dhe adresimin e tematikave të trajnimit, Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit konsultohet me programet e kurseve të Shkollës së Magjistraturës, të miratuara nga Këshilli Drejtues i saj, si dhe me institucionet vendase dhe të huaja që ofrojnë njohuri në fushën antikorrupsion;
- ii) të hartojë listën e koordinatorëve që do të marrin pjesë në aktivitetet e formimit profesional, në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të Antikorrupsionit;

iii) të caktojë një person kontakti në cilësinë e koordinatorit, i cili do të kujdeset për mbarevajtjen e zhvillimit të aktiviteteve të formimit profesional / trajnimeve.

iv) të përcaktojë formatin e regjistrimit të të dhënave lidhur me frekuentimin dhe tematikën e aktiviteteve të formimit profesional.

Neni 5

Angazhimet e Shkollës së Magjistraturës

Shkolla e Magjistraturës angazhohet:

i) të përcaktojë listën e aktiviteteve që do të përfshihen në programin e formimit profesional të koordinatorëve;

ii) të sigurojë teknikën dhe metodologjinë e zhvillimit të programit të formimit profesional të koordinatorëve;

iii) të përcaktojë kalendarin e aktiviteteve të formimit profesional të koordinatorëve dhe e vendos atë në dispozicion të Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit.

Neni 6

Kontribute të përbashkëta

1. Palët angazhohen të informojnë reciprokisht njëri-tjetrin sipas angazhimeve të ndërmarra në këtë marrëveshje, si dhe marrin përsipër të bashkëpunojnë për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, për formimin profesional të koordinatorëve në luftën kundër korrupsionit, me qëllim forcimin e zbatueshmërisë së ligjit dhe rritjen e integritetit të koordinatorëve.

2. Palët marrin përsipër të kryejnë bashkarisht:

a) caktimin e modeleve për certifikimin e pjesëmarrësve;

b) hartimin e pyetësorëve të vlerësimit të aktiviteteve trajnuese;

c) sigurimin e mjeteve teknike të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve të formimit profesional.

Neni 7

Komunikimi ndërmjet palëve

1. Palët angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë marrëveshje. Komunikimi kryhet në formë shkresore dhe/ose në rrugë elektronike.

2. Palët caktojnë një person kontakti, nëpërmjet të cilit do të kryhet shkëmbimi i informacionit në kuadër të zbatimit të kësaj marrëveshje bashkëpunimi. Palët, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga nënshkrimi i marrëveshjes, caktojnë një person kontakti dhe ia njoftojnë atë njëra-tjetrës.

Neni 13
Dispozita të fundit

1. Marrëveshja përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale me të njëjtën fuqi juridike, 2 (dy) prej të cilave depozitohen në Ministrinë e Drejtësisë dhe 2 (dy) të tjera në Shkollën e Magjistraturës.
2. Kjo marrëveshje bashkëpunimi u nënshkrua sot, më datë ____ .01.2023.

**KOORDINATORI KOMBËTAR
KUNDËR KORRUPSIONIT**

ULSI MANJA

(Ministër i Drejtësisë)



SHKOLLA E MAGJISTRATURËS

ARBEN RAKIPI

(Drejtör)

